



VENDIM

Nr.25 Datë 29.03.2010

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “HYDROENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5 pika 1 gërma”a”, nenit 13 dhe nenit 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.03.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HYDROENERGY” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “HYDROENERGY” shpk në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Murdhari 1 me fuqi 2.68 MW dhe HEC Murdhari 2 me fuqi 1 MW.

2. “HYDROENERGY” shpk shpk të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
3. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet.
 4. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftojne aplikuesin per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjeherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta

Adresa: Blvd "Gjergj Fishta" Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@cre.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.cre.gov.al